

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË " Chefmarkt " SH.P.K.

Sot, me datë 01/03/2023

Z. Mark Schüler, shtetas i huaj, lindur më 23.08.1979 në Berlin- Lichtenberg, Gjermani, mbajtës I kartes se Id me nr. L73YK59Z2 madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Znj. Jolanda Prinz Geb.Lika, shtetas i huaj, lindur më 18.06.1987 në Lushnje , Shqiperi, mbajtës I kartes se Id me nr. L73Y8CZML madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar " **Chefmarkt "Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është “ **Chefmarkt” Sh.p.k.**

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën : TIRANE Njesia Bashkiake nr.7, Rruga Ndre Mjeda, ndertesa nr.31, hyrja nr.2, kodi postar 1023.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Rekrutim dhe menaxhim punonjesish te kualifikuar ne Shqiperi, per tregun gjerman dhe nderkombetar..

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpérblimi dhe çdo garanci tjetër reale.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimitarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 2.000.000 Lek dhe është i ndarë në 2 kuota

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z.Mark Schüler** zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1,000,000 Lek dhe 1,000,000 Lek të kapitalit themeltar.
- **Znj.Jolanda Prinz Geb.Lika** zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1,000,000 Lek dhe 1,000,000 Lek të kapitalit themeltar

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Elsen Troshani**, shtetas Shqiptar, lindur më 24/07/1977 në Shkoder, Shqiperi, mbajtës i kartes me nr 036160218 dhe nr. Personal H70724048R, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar., i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Z. *Mark Schüler*



Znj. *Jolanda Prinz Geb.Lika*

